



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 243 /2018

Datë: 30 maj 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 30 maj 2018, mori këtë:

VENDIM

- I. Për shpalljen e brendshme për pesë (5) pozita për avancim të prokurorëve të shtetit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- II. Shpallja duhet të përmbajë informatat e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit Nr. 06/L - 025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe Rregulloren Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe Shpalljen për avancim t'i publikojë në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.


Blerim Isufaj
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorëve të prokurorive;
- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.